

30 DITË në AMA

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Fq. 2


Kryetarja e AMA-s takohet me drejtues të lartë të OSHMA-ve, për projektligjin, “Për lirimin e frekuencave të Digital Dividend Dy”

Në ambientet e Autoritetit të Mediave Audiovizive, u zhvillua një takim me drejtues të lartë të OSHMA-ve, për konsultimin e ...



Fq. 2

Forumi i 12-të i BRAF në Shqipëri: Drejtues të rregullatorëve, vende anëtare dhe përfaqësues të lartë të BSEC mbledhen në Vlorë



Fq. 2

Monitorimi i përmbajtjeve, në muajin gusht mbizotëruan lajmet sociale


Muaji gusht ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Sipas të dhënave të përlogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në...

Kryetarja e AMA-s merr pjesë në mbledhjen e parë të Komitetit të Monitorimit të Instrumentit RGF

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në takimin e parë të Komitetit të Monitorimit të Instrumentit “Faciliteti i Reformave dhe Rritjes” (RGF), që ...



Fq. 2



Fq. 3

Koha për partitë politike në edicionet informative gjatë muajit gusht

Të dhënat e monitorimit të përmbajtjeve, të nxjerra nga ekipet e analizës në AMA, përmbajnë informacione të plota dhe interesante mbi...


Forumi i 12-të i BRAF në Shqipëri: Drejtues të rregullatorëve, vende anëtare dhe përfaqësues të lartë të BSEC mbledhen në Vlorë

Autoriteti i Mediave Audiovizive organizoi në qytetin e Vlorës, Forumin e 12-të të Autoriteteve Rregullatore të Transmetimeve të Detit të Zi (BRAF). Tema kryesore që u diskutua në takimin dyditor ishte: “Gjuha e urrejtjes në median audiovizive dhe online dhe e drejta për informim”. Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, në fjalën e hapjes së këtij takimi, ka vënë theksin te rëndësia që duhet t’i kushtohet gjuhës së urrejtjes: “Është një sfidë e rëndësishme me të cilën përballet jo vetëm tregu mediatik, por edhe entet rregullatore,”- tha



Kryetarja e AMA-s takohet me drejtues të lartë të OSHMA-ve, për projektligjin, “Për lirimin e frekuencave të Digital Dividend Dy”

Në ambientet e Autoritetit të Mediave Audiovizive, u zhvillua një takim me drejtues të lartë të OSHMA-ve, për konsultimin e Projektligjit, “Për lirimin e frekuencave të Digital Dividend Dy (DD2). Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ka ftuar operatorët që preken nga procesi i lirimit të brezit 700 MHz, që bëhet me qëllim harmonizimin e përdorimit të spektrit në përputhje me praktikën e Bashkimit Europian dhe rekomandimet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve (ITU). Me drejtuesit e OSHMA-ve u diskutuan kushtet e këtij kalimi, të parashikuara në projektligjin e hedhur për konsultim publik. [Lexo më shumë](#)



Monitorimi i përmbytjeve, në muajin gusht mbizotëruan lajmet sociale

Muaji gusht ka prodhuar më shumë lajme sociale për mediat audiovizive. Sipas të dhënave të përlogaritura nga ekipet e monitorimit dhe analizës në Autoritetin e Mediave Audiovizive, pas sociale me 22.15%, vijnë lajmet ndërkombëtare me 16.28%, të ndjekura nga ato të kronikës së zezë me 10.34%


[Lexo më shumë](#)

Kryetarja e AMA-s merr pjesë në mbledhjen e parë të Komitetit të Monitorimit të Instrumentit RGF



Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive Znj. Armela Krasniqi mori pjesë në takimin e parë të Komitetit të Monitorimit të Instrumentit “Faciliteti i Reformave dhe Rritjes” (RGF), që bashkëkryesohet nga Koordinatori Kombëtar për RGF dhe përfaqësues të Komisionit Europian. Ky Komitet përfaqëson takime të nivelit të lartë dhe në mbledhjen e parë të tij u diskutua progresi në zbatimin e Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027, cilësia, sfidat dhe përputhshmëria e zbatimit të masave në kuadër të Instrumentit RGF, si dhe hapat e mëtejshëm për arritjen e objektivave të vendosura.

[Lexo më shumë](#)



Koha për partitë politike në edicionet informative gjatë muajit gusht

Të dhënat e monitorimit të përmbytjeve, të nxjerra nga ekipet e analizës në AMA, përbajnë informacione të plota dhe interesante mbi aktivitetin mujor të televizioneve kryesore. Kështu sipas të dhënave rezulton se Partia Demokratike e Shqipërisë ka zënë 90.20% të kohës në edicionet e lajmeve, pasuar nga Partia Socialiste me 4.81%.

[Lexo më shumë](#)